



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.190, datë 16.08.2024

“PËR PRANIMIN E ANKIMIT”

Në mbështetje të nenit 49 të ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 113, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 189 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë” i ndryshuar, nenet 17 germa “ë” dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale, pasi u njoh me ankesën e zonjës Besiana Sadikaj, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, kundër vendimit të drejtuesit të Prokurorisë “Për pranimin e kërkesës së Oficerit të Policisë Gjyqësore zj. Noreta Kalcuni” të datës 08.08.2024, administruar në institucion me nr. 2087/1 prot., datë 14.08.2024, bazuar në relacionin e paraqitur për shqyrtim nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Pranimin e ankesës së prokurores Besiana Sadikaj kundër vendimit nr. 1144/9 prot., datë 08.08.2024, të drejtuesit të prokurorisë “Për pranimin e kërkesës së Oficerit të Policisë Gjyqësore zj. Noreta Kalcuni”, si të bazuar në ligj dhe në prova.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 1144/9 prot., datë 08.08.2024, të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë “Për pranimin e kërkesës së Oficerit të Policisë Gjyqësore zj. Noreta Kalcuni”, si të pabazuar në ligj dhe në prova.
3. Procedimi penal nr. 380/2024 i caktohet prokurores Besiana Sadikaj.
4. Relacioni shpjegues është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Të njoftohet për këtë vendim prokurorja Besiana Sadikaj, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë dhe Prokurori i Përgjithshëm.
6. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë e publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
7. U shpall në Tiranë, më 16.08.2024

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



ANËTAR
Arta Mandro



ANËTAR
Olger Eminaj



ANËTAR
Moisi Duda



ANËTAR
Erind Merkuri



ANËTAR
Vatë Staka



ANËTAR
Erind Gërmenji

